



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 24 Dhjetor 2020

Nr: 10

V E N D I M

PËR

MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE MODALITETEVE PËR LLOGARITJEN E VLERËS MONETARE TË DHURIMEVE NË NATYRË OSE SHËRBIMEVE, HUAVE DHE KREDIVE PËR QËLLIME ZGJEDHORE OSE POLITIKE TË PËRFITUARA NGA PARTITË POLITIKE DHE KANDIDATËT GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE

Komisioni Rregulator, në mbledhjen e tij të datës 24.12.2020, me pjesëmarrjen e:

Ilirjana	NANO -	Kryetare
Arens	ÇELA -	Anëtar
Dritan	ÇAKA -	Anëtar
Helga	VUKAJ -	Anëtare
Muharrem	ÇAKAJ -	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Rregullat dhe modalitetet për llogaritjen e vlerës monetare të dhurimeve në natyrë ose shërbimeve, huave dhe kredive për qëllime zgjedhore ose politike të përfituara nga partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatës zgjedhore.

BAZA LIGJORE: Neni 20 paragrafi 1, shkronja "f", neni 86 shkronjat "c" e "ç", neni 90, paragrafët 1 e 2, nenin 92/1 paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.



Data: 24 Dhjetor 2020
Nr. 10

Për miratimin e rregullave dhe modaliteteve për llogaritjen e vlerës monetare të dhurimeve në natyrë ose shërbimeve, huave dhe kredive për qëllime zgjedhore ose politike të përfituara nga partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatës zgjedhore

Komisioni Rregulator bazuar në nenin 20 paragrafi 1, shkronja “f”, nenin 86. shkronjat “c” e “ç”, nenin 90 paragrafët 1 e 2, nenin 92/1 paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

VËREN:

Referuar nenit 20, paragrafi 1, shkronja “f”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregulator ka kompetencën për “...miratimin e projekt aktit me karakter normativ, të përgatitur nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose nga anëtarët e tij, për rregullat për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore...”;

Referuar nenit 86, paragrafi 1, shkronjat “c” e “ç” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, burimet e financimit të fushatës për subjektet zgjedhore janë edhe:

“...c) dhuratat për subjektin zgjedhor dhe kandidatët e tij, në vlerë monetare, natyrë ose shërbime të dhëna, sipas nenit 92/1 të këtij ligji;

ç) huatë ose kreditë e marra nga partitë politike ose kandidatët e tyre sipas ligjit. Në asnjë rast vlera e një huaje ose kredie nuk duhet të kalojë shumën e fondeve, sipas pragafit 2 të nenit 92/1 të këtij ligji...”;

Referuar nenit 90, paragrafët 1 e 2, të ligjit, nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton me vendim rregullat dhe modalitetet e nevojshme për llogaritjen e vlerës monetare të dhurimeve në natyrë ose të shërbimeve të dhëna sipas vlerës së tregut në momentin e dhënies së tyre. Për qëllime të zbatimit të ligjit, dhurimet në vlera monetare, në natyrë apo në formën e shërbimit që u jepen kandidatëve të subjekteve zgjedhore, si dhe huatë ose kreditë e marra nga kandidatët për financimin e fushatës konsiderohen si kontribute për partinë politike për të cilën ata kandidojnë. Për kandidatët e propozuar nga koalicionet, partitë politike pjesëmarrëse në koalicion përcaktojnë në marrëveshjen për krijimin e koalicionit se cila parti do të deklarojë të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatit.”

Referuar nenit 92/1 paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se “...shuma që çdo person fizik ose juridik mund t'i japë një subjekti zgjedhor, përfshirë kandidatët e tij, nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose kundërvlera në sende ose shërbime...”;



Data: 24 Dhjetor 2020
Nr. 10

Për miratimin e rregullave dhe modalitetëve për llogaritjen e vlerës monetare të dhurimeve në natyrë ose shërbimeve, huave dhe kredive për qëllime zgjedhore ose politike të përsituara nga partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatës zgjedhore

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Rregulator bazuar në nenin 20, paragrafi 1, shkronja "f", nenin 86 shkronjat "c" e "ç", nenin 90, paragrafët 1 e 2, nenin 92/1 paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

V E N D O S I:

1. Në kuptim të këtij vendimi, dhurimet në natyrë janë dhurimet në formë mallrash/produktesh dhe shërbimesh të ofruara pa pagesë ose me një çmim më të ulët se ai i tregut, huatë dhe kreditë me përqindje më të ulët se norma e interesit të tregut ose pa normë interesit.
2. Vlera monetare e dhurimeve vërtetohet nga dokumentacioni i mbajtur nga përfituesi dhe dhuruesi në momentin e dhurimit.
3. Kur një zgjedhës ofron kohën e tij/saj pa pagesë për të ndihmuar fushatën zgjedhore, atëherë veprimitaria e zgjedhësit do të quhet "veprimitari vullnetare" dhe jo dhurim në natyrë të veprimitarisë së subjektit zgjedhor.
4. Dhurimet në natyrë përfshijnë çdo lloj të ardhure që nuk merret në formë monetare, por në natyrë, në formë produktesh/mallrash e shërbimesh.
5. Dhurimet në natyrë ose shërbimet i nënshtrohen të njëjtave rregulla regjistrimi si ato monetare.
6. Dhurimet në natyrë duhet të raportohen nga subjekti zgjedhor sikurse dhurimet në para dhe duhet të përllogariten në vlerë monetare. Vlera monetare e tyre llogaritet sipas mënyrës së përcaktuar në këtë vendim.
7. Dhurimet në natyrë raportohen si dhuratë në fushatë dhe njëkohësisht si shpenzim i fushatës.
8. Përllogaritja e vlerës monetare të dhurimeve në natyrë dhe shërbimeve për qëllime zgjedhore ose politike, të përfituar nga partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatës zgjedhore bëhet në bazë të vlerës së tregut në momentin e dhënies/përfitimit të tyre.
9. Në rastet kur dhurimet ose shërbimet apo mallrat ofrohen pa pagesë ose me çmim më të ulët sesa çmimi i të njëjtave shërbime apo mallra në kushtet e tregut, atëherë diferenca ndërmjet shumës që subjekti zgjedhor do të paguante për mallrat ose shërbimet sipas çmimeve të tregut me shumën që paguan realisht, konsiderohet si dhurim në natyrë.
10. Çmimi i tregut për mallra dhe shërbime do të përcaktohet me një nga metodat e mëposhtme:
 - a) Nëse është e mundur, duke iu referuar indeksit mujor të çmimeve, të publikuara nga INSTAT, në kohën kur mallrat/shërbimet janë ofruar;
 - b) Nëse furnitori operon në biznesin e ofrimit të këtyre të mirave dhe shërbimeve, çmimi i tregut do të jetë vlera normale tregtare që aplikon furnitori për to, ose



Data: 24 Dhjetor 2020

Nr. 10

Për miratimin e rregullave dhe modaliteteve për llogaritjen e vlerës monetare të dhurimeve në natyrë ose shërbimeve, huave dhe kredive për qëllime zgjedhore ose politike të përfituar nga partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatës zgjedhore

3

- c) Nëse nuk realizohet së pari, metoda e përcaktuar në shkronjën “a” dhe më pas ajo në shkronjën “b” të kësaj pike, subjekti zgjedhor llogarit çmimin e tregut mbi bazën e mesatares së çmimeve të ofruara nga tre ofrues mallrash /shërbimesh të ngjashme.
11. Subjekti zgjedhor kur raporton të ardhurat dhe shpenzimet për veprimtaritë, mallrat apo shërbimet, është i detyruar të referojë dhe dokumentojë metodën e aplikuar për përllogaritjen sipas pikës 10 të këtij vendimi. Aplikimi i metodës së përllogaritjes jepet në shembujt sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, të cilat paraqiten për qëllime ilustrimi dhe nuk janë shteruese.
 12. Kreditë/huatë janë një formë tjetër e burimit të ligjshëm të financimit për fushatën zgjedhore. Kreditë do të llogariten përkundrejt tavanit të dhurimit prej 1 milion lekë. Kushtet e kontratës së kredisë do t'i nënshtrohen auditimit si çdo burim tjetër financimi për çdo subjekt politik/subjekt zgjedhor.
 13. Diferenca ndërmjet shumës që subjekti zgjedhor do paguante me normën e interesit të tregut për shumën e marrë me kredi ose hua me shumën që do paguajë me normën e interesit që ka marrë realisht konsiderohet si dhurim në natyrë.
 14. Udhëzimi nr. 3, datë 02.06.2017, i Komisionit Qendoror të Zgjedhjeve, “Për mënyrën e përllogaritjes së kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore”, shfuqizohet.
 15. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
 16. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendoror të Zgjedhjeve.

Ilirjana NANO -

Kryetare 


Arens ÇELA -

Anëtar 

Dritan ÇAKA -

Anëtar 

Helga VUKAJ -

Anëtare 

Muharrem ÇAKAJ -

Anëtar 



SHTOJCA 1

SHEMBUJ PËR METODËN E PËRLLOGARITJES SË DHURIMEVE NË NATYRË SIPAS KËTIJ VENDIMI

Shembull 1:

Subjekti zgjedhor A (SZA) kërkon të marrë me qera pajisje audio-vizuale për mitingun e hapjes së fushatës në Tiranë. Shoqëria "Shiko dhe Dëgjo" është ofruar t'i japë pajisjet për këtë organizim me një kosto prej 135,000 (njëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë. Normalisht, kjo shoqëri do të kërkonte njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë 165,000 lekë për një organizim të tillë, por Administratori i shoqërisë "Shiko dhe Dëgjo" ka dëshirë të mbështesë SZA-në.

Në këtë rast, subjekti zgjedhor SZA duhet të raportojë një dhurim në natyrë prej 30,000 (tridhjetë mijë) lekë nga shoqëria "Shiko dhe Dëgjo" në reportin e tij të raportimit sipas formularit tip, miratuar me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Shembull 2:

Shoqëria "Karrige me Mbështetëse" i dhuron kandidatit A 100 karrige për t'i përdorur gjatë takimeve të fushatës për një periudhë dy-javore. Shoqëria normalisht kërkon 75,000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë për këtë lloj qiraje. Në qoftë se Kandidati A nuk paguan asgjë, atëherë ky dhurim në natyrë në vlerën 75,000 (shtatëdhjetë e pesë mijë shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë duhet të registrohet. Kandidati A mund t'i referohet INSTAT-it për të parë nëse ka një normë të caktuar.

Nëse Shoqëria "Karrige me Mbështetëse" vetëm shet karrige dhe zakonisht nuk i jep ato me qira, atëherë Kandidati duhet të marrë normën e çmimeve nga tre shoqëri që ofrojnë shërbimin e dhënies së karrigeve me qera. Mesatarja e tri ofertave do të raportohet si shuma e dhurimit në natyrë.

Shembull 3:

Individ i X është një mbështetës i madh i Subjektit Zgjedhor A (SZA) dhe mik i vjetër i Kandidatit B, i cili është në listën e kandidatëve të SZA-së. Individ i X i dhuron SZA-së 125,000 (njëqind e njëzetë e pesë mijë) lekë. Ai i jep gjithashtu kandidatit B 125,000 (njëqind e njëzetë e pesë mijë) lekë dhe 25,000 (njëzetë e pesë mijë lekë) degës lokale të SZA-së. Gjatë fushatës, Individ i X shpërndan fletushka tek familjet e lagjes së tij në dy raste. Individ i X gjithashtu pajton dikë të ndihmojë fushatën me kryerjen e telefonatave. Individ i X e paguan këtë person me 40,000 (dyzetë mijë) lekë. Së fundmi, Individ i X i jep Kandidatit B të përdorë pa pagesë mjediset e zyrës në ndërtesën e tij tregtare. Normalisht, ai do ta jepte me qira atë hapësirë për 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj.



Data: 24 Dhjetor 2020

Nr. 10

Për miratin e rregullave dhe modaliteteve për llogaritjen e vlerës monetare të dhurimeve në natyrë ose shërbimeve, huave dhe kredive për qellime zgjedhore ose politike të përsituara nga partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatës zgjedhore

Kontributi i Individit X për fushatën arrin në total vlerën 365,000 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë. Secili dhurim do duhet të reflektohet në reportin e financimit të fushatës zgjedhore si e ardhur. Përveç kësaj, në formularin tip miratuar me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve do të përfshihen automatikisht dhurimet në natyrë që arrijnë në total 90,000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, si shpenzime të SZA-së.

Shembull 4:

Albanian Mega Estate vë në dispozicion të Subjektit Zgjedhor A (SZA) ambiente për zyra elektorale për periudhën një muaj para fillimit të fushatës deri një javë pas përfundimit të zgjedhjeve. Qiraja e zakonshme mujore për këto zyra është 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Albanian Mega Estate ka bërë kështu dhurim në natyrë për SZA në shumën 350,000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë (kosto e qirasë që partia do duhet të paguante për zyrën elektorale sipas çmimit të tregut). Kjo shumë duhet të raportohet në reportin për financimin e fushatës zgjedhore si dhurim në natyrë.

Shembulli 5:

Albanian Super Financial i jep subjektit zgjedhor A (SZA) hua në shumën 2.000.000 (dy milion) lekë me nivel interesi 1%, në vend të nivelit 4% që zbatohet në treg, i pagueshëm pas një viti.

Albanian Super Financial ka bërë kështu dhurim në natyrë në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë (diferenca midis shumës së pagueshme nga SZA me shumën e pagueshme sipas interesit me vlerën e tregut). Kjo shumë duhet të raportohet si dhurim në natyrë. Huaja është e paligjshme, sepse kapërcen kufirin prej një 1.000.000 (një million) lekësh për dhuratat dhe huatë.

Shembulli 6:

Individu X, mbështetës i SZA dhe biznesmen, shpenzon drejtpërdrejtë 2.000.000 (dy milion) lekë për organizimin e një mitingu elektoral të SZA.

Individu X ka bërë kështu një dhurim në natyrë në shumën 2.000.000 (dy milion) lekë, me shumën një 1.000.000 (një milion) lekë si dhurim i paligjshëm.



Data: 24 Dhjetor 2020
Nr. 10

Për miratimin e rregullave dhe modaliteteve për llogaritjen e vlerës monetare të dhurimeve në natyrë ose shërbimeve, huave dhe kredive për qellime zgjedhore ose politike të përfituar nga partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatës zgjedhore

6